



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 janar 2023
Nr. ref.:RK 2112/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI211/21

Parashtrues

Nenad Arsić

Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjkimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 280/2021 i 5 shtatorit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nenad Arsić, nga fshati Çagllavicë, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Dejan Vasić, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 280/2021] të 5 shtatorit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [ASP. nr. 117/2021] të 12 majit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti Special (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [PS. nr. 55/2019] të 24 dhjetorit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 dhjetor 2021, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [Nr. GJR. KI211/21] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci, anëtarë.
7. Më 6 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë.
8. Më 8 dhjetor 2021, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 13 janar 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë.
10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 22 dhjetor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Bazuar në shkresat e lëndës, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, më 6 dhjetor 2019, ka ngritur aktakuzën [PPS. nr. 01/2016] kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar për kryerje të veprës penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Në tekstin e mëtejme: LP RSFJ), e inkriminuar si vepër penale e krimit të luftës, në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës sipas nenit 144, paragrafi 2, nënparagrafët 2.2 dhe 2.3, lidhur me paragrafin 1, nënparagrafin 1.2 në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK), si dhe për shkak të veprës penale të bashkëpunimit në krime të luftës kundër popullatës civile nga neni 142, në lidhje me nenin 22 të Kodit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ), e dënueshme si vepër penale e krimit të luftës, duke shkelur rëndë Konventat e Gjenevës sipas nenit 144, paragrafi 2, nënparagrafi 2.4, lidhur me paragrafin 1, nënparagrafi 1.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.
13. Më 24 dhjetor 2019, ishte mbajtur seanca fillestare sipas nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK), në të cilën parashtruesi i kërkesës ishte deklaruar që nuk është fajtor.
14. Në një datë të pasaktësuar, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, kishte parashtruar kërkesë për hedhje poshtë të aktakuzës dhe kundërshtim të provave sipas nenit 249 të KPPK-së.
15. Më 20 janar 2020, kryesuesja e trupit gjykues, me aktvendim kishte refuzuar kërkesën e mbrojtjes për hedhje poshtë të aktakuzës, pasi që gjykata kishte konsideruar që aktakuza përmban të gjitha elementet e parapara ligjore.
16. Sipas shkresave të lëndës, aktvendimi për vërtetimin e aktakuzës është bërë i plotfuqishëm më 7 shkurt 2020, sipas vendimit [PN. 1. S. nr. 15/2020] të Gjykatës së Apelit.
17. Më 1 dhjetor 2020, Prokuroria kishte parashtruar aktakuzën e ndryshuar vetëm në lidhje me kualifikimin e veprës penale. Nga aktakuza e të pandehurit për dy veprat penale të përshkruara më lart, të krimeve të luftës, ka hartuar kualifikimin juridik për një vepër penale, për krime të luftës, në bazë të faktit se bëhet fjalë për ngjarjen e cila ka ndodhur të njëjtën ditë, kohë dhe për shkak të motiveve, respektivisht për veprën penale krime të luftës kundër popullatës civile në bashkëkryerje, sipas nenit 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, e cila aktualisht është e inkriminuar si krime të luftës, në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës nga neni 144, paragrafi 2, nënparagrafët 2.2, 2.3 dhe 2.4, lidhur me paragrafin 1, nënparagrafin 1.1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
18. Më 24 dhjetor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special me Aktgjykimin [PS. nr. 55/2019], parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për veprën penale krime lufte kundër popullsisë civile nga neni 142 dhe 22 i Kodit Penal të ish-Jugosllavisë në lidhje me nenin 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, neni 4, paragrafi 2, pika a) dhe g) e Protokollit II të 8 qershorit 1977, Shtojca e Konventës së Gjenevës, dhe të njëjtin e dënoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vitesh, në të cilin është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga 22 tetori 2019 e tutje. Parashtruesi i kërkesës ishte i detyruar të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 500 eurove, si dhe shumën prej 50 eurove në fondin për kompensimin e

viktimave të luftës, ndërsa palët e dëmtuara për realizimin e kërkesave të tyre pasurore-juridike u udhëzuan në kontest gjyqësor.

19. Më 11 mars 2021, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit të Kosovës ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta lirojë të akuzuarin nga akuza për veprën penale e cila i vihet në barrë, po ashtu edhe përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtroi ankesë, për shkak të shkeljes së Ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1, pikat 1.1 dhe 1.2 të KPRK-së, gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga neni 386, paragrafi 1 i KPRK-së dhe vendimit për dënimin me propozimin që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar duke e liruar të dënuarin nga vepra penale ose duke e anuluar atë dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje. Ankesë kishte parashtruar edhe Prokuroria Speciale lidhur me vendimin për sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit ta miratojë ankesën dhe ta modifikojë aktgjykimin e kundërshtuar duke i shqiptuar të akuzuarit dënim më të lartë me burgim.
20. Më 12 maj 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [APS. nr. 11/12021] refuzoi si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe atë të parashtruesit të kërkesës dhe të përfaqësuesit të tij, duke e konfirmuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
21. Më 21 korrik 2021, kundër aktgjykimeve të gjykatave të shkallës së parë dhe dytë, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve të Ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit të gjykatës, me propozimin që Gjykata Supreme ta miratojë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të bazuar, aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshojë ashtu që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga akuzat për veprën penale për të cilën është dënuar apo që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë apo të dytë për rigjykim.
22. Më 5 shtator 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 280/2021] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga ana e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 280/2021] e 5 shtatorit 2021 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta Për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, pasi që siç pohon ai ishte dënuar në bazë të deklaratave të rreme të dëshmitarëve, ku lidhur me këtë thekson se *“Deklaratat e këtyre dëshmitarëve janë krejtësisht kontradiktore, duke filluar nga kallëzimi penal në të cilin është denoncuar i dënuari, duke vazhduar me deklaratat e tyre në polici e më pas në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë konstatoi se deklaratat ishin kontradiktore, por me kalimin e kohës të dëmtuarit e ulnin intensitetin e akuzave, andaj ajo u besoi. Në aktgjykimin e saj në kundërshtim me nenin 404, paragrafi 1 i KPPRK-së, Gjykata e Apelit nuk u përgjigj fare në pretendimet e bëra në ankesat tona nga i dënuari Nenad Arsić si dhe unë si mbrojtës i tij. Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin e saj konfirmoi se kishim të*

bënim me deklaratat kontradiktore, por konstatoi se nuk ishte fjala për dallime të mëdha”.

25. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se është shkelur neni 120 i KPPK-së, ku thekson se *“Gjykata e shkallës së parë e pranon deklaratën mbi identifikimin edhe pse kjo deklaratë është e rreme sepse këtë e ka konfirmuar edhe Skënder Shala kur thotë se ma kanë sjellë dy herë albumin me nga 20 fotografi dhe nuk kam mundur ta njohë Nenadin por më ka treguar Jakupi. Si mund të më njohë pasi kurrë në jetë nuk më ka parë, por edhe kur më kanë përshkruar në Polici të Kosovës, edhe Skënderi edhe Jakup Shala gjithashtu kanë thënë në të gjitha deklaratat se këtë person e njohin mirë para lufte dhe kanë dhënë përshkrimin se ky person i ka flokët e kaltra, sytë e kaltra, është i gjatë 1,70 – 1,75 dhe se është i moshës rreth 30 – 35 vjeç e që unë nuk jam ai dhe nuk dukem ashtu, këtë gjë të njëjtë e kam pyetur Kolegjin gjyqësor për çka kam marrë përgjigje se Jakupi më ka përshkruar saktë, me flokët e kaltra, dhe fjalët e mija nga fjala përfundimtare ku kam thënë se unë nuk jam i gjatë 170 – 175 por 184. Sikur të ishte respektuar ligji, neni 120, 1 deri 5, unë tani nuk do të isha këtu për t’ju drejtuar juve për ndihmë”.*
26. Më tej parashtruesi i kërkesës pretendon se gjyqtari B. A., i cili kishte qenë gjyqtar në Gjykatën e Apelit kur ishte vendosur për ankesën e tij, i njëjti kishte marrë pjesë në vendimmarrje edhe lidhur me procedurën paraprake, që sipas tij nuk ka të drejtë sipas ligjit. Lidhur me këtë, parashtruesi thekson se *“ai atëbotë më ka akuzuar për humbje të 16.000 markave, ndërsa tani e vërteton aktgjykimin ku përmenden 120.000 marka, ndërsa gjykata pretendon për 122.000 marka, a është kjo në rregull”.*
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që të marrë vendim për lirimin e tij nga përgjegjësia për shkak të mungesës së provave.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

30. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individë mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.

31. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 280/2021] e 5 shtatorit 2021 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
32. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

33. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, rastet e Gjykatës [KIo4/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
34. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GjEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës*, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNJ-së, *Kemmache kundër Francës*, nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), *Juta Mentzen kundër Lituanisë*, nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
35. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin [KIo4/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
36. Rrethanat e rastit konkret kanë të bëjnë me aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, më 6 dhjetor 2019 [PPS. nr. 01/2016] kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të veprës penale të krimit të luftës kundër popullatës civile nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (në tekstin e mëtejshëm: LP RSFJ), e inkriminuar si vepër penale e krimit të luftës, në shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës sipas

nenit 144, paragrafi 2, nënparagrafët 2.2 dhe 2.3, lidhur me paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, si dhe për shkak të veprës penale të bashkëpunimit në krime të luftës kundër popullatës civile nga neni 142, në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, (KP RSFJ), e dënueshme si vepër penale e krimit të luftës, duke shkelur rëndë Konventat e Gjenevës sipas nenit 144, paragrafi 2, nënparagrafi 2.4, lidhur me paragrafin 1, nënparagrafi 1.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Parashtruesi i kërkesës nga ana e Gjykatës Themelore ishte shpallur fajtor për kryerjen në bashkëkryerje të veprës penale krime lufte kundër popullatës civile dhe ishte dënuar me dënim me burgim prej 6 (gjashtë) vitesh. Parashtruesi i kërkesës ishte ankuar në Gjykatën e Apelit lidhur me dënimin e tij nga ana e Gjykatës Themelore, ankesa e të cilit ishte refuzuar si e pabazuar. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, ku kjo e fundit e kishte refuzuar kërkesën e tij.

37. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ngre pretendimin se Gjykata Supreme ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, përkatësisht shkelje të nenit 120 të KPPK-së, pasi që, siç pohon ai ishte dënuar në bazë të deklaratave të rreme të dëshmitarëve, ku lidhur me këtë thekson se *“Deklaratat e këtyre dëshmitarëve janë krejtësisht kontradiktore, duke filluar nga kallëzimi penal në të cilin është denoncuar i dënuari, duke vazhduar me deklaratat e tyre në polici e më pas në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë konstaton se deklaratat ishin kontradiktore, por me kalimin e kohës të dëmtuarit e ulnin intensitetin e akuzave, andaj ajo u besoi. Në aktgjykimin e saj në kundërshtim me nenin 404, paragrafi 1 i KPPRK-së, Gjykata e Apelit nuk u përgjigj fare në pretendimet e bëra në ankesat tona nga i dënuari Nenad Arsić si dhe unë si mbrojtës i tij. Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin e saj konfirmoi se kishim të bënim me deklaratat kontradiktore, por konstatoi se nuk ishte fjala për dallime të mëdha”*.
39. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga gjykatat e rregullta.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtrues *Belgjiyar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17 dhe KI05/18](#), me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).

41. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues Qemajl Babuni, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 35).
42. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të të cilave dispozita materiale kanë nxjerrë vendimet përkatëse, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, po ashtu edhe dëshmisë së dëshmitarëve.
43. Së pari, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [ST. nr. 55/2019] të 24 dhjetorit 2020, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës, për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale të krimit të luftës kundër popullatës civile nga neni 142, lidhur me nenin 22 të Ligjit penal të RSFJ-së, në lidhje me nenin 3 të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949, neni 4, paragrafi 2, pikat a), e) dhe g) të Protokollit II të 8 qershorit 1977, Shtojcë e Konventave të Gjenevës dhe e dënoi me dënim me burg prej 6 (gjashtë) vitesh.
44. Gjykata Themelore, ndër të tjera, në arsyetimin e Aktgjykimit theksoi: “[...] Trupi gjykues gjendjen faktike si në hyrje të këtij aktgjykimi e ka bazuar në deklaratat e dëshmitarëve Jakup dhe Skënder Shala, të cilat pas analizimit i kanë vërtetuar si të deklaratat të besueshme. Dëshmitarët kujtojnë ngjarjen si dëshmitarë okularë. Kanë qenë bindës, të saktë dhe kanë vërtetuar në mes vete në raport me ngjarjet e përgjithshme të cilat iu janë referuar torturimit, rrahjes së tyre që janë kryer nga ana e të pandehurit dhe fyerjeve dhe poshtërimeve të cilat iu janë bërë. Dëshmitarët madje kanë vërtetuar njëri-tjetrin lidhur me mënyrat e përdorura nga ana e të pandehurit në kryerjen e rrahjes si dhe në lidhje me detajet të cilat e kanë karakterizuar rrahjen, respektivisht faktin që i akuzuari duke e goditur me shkop (bastun) i ka thënë të dëmtuarit Jakup që shkopin tjetër t’ia dërgojë nënës së tij. Pastaj fakti që gjatë aksioneve kanë kënduar këngë nacionaliste dhe së bashku me anëtarët tjerë kanë pirë alkool dhe kanë ngrënë ushqim, kur në një moment e kanë detyruar edhe dëshmitarin Jakup të këndojë këngë serbe dhe të pijë alkool. Të gjitha këto detaje, dëshmitarët vazhdimisht i kanë raportuar Trupi gjykues i falë besimin deklaratave të dëshmitarëve Jakup dhe Skender Shala dhe është i bindur që ata kanë thënë të vërtetën sepse deri te dita kritike, dëshmitarët dhe i pandehuri nuk kanë pasur mospajtime ose tensione. Qëllimisht kishte në shënjestër viktimat dhe kundër tyre ka kryer veprime të inkriminuara, siç është përmendur më lart. Pasi që ai i ka njohur më parë dhe që ka qenë i vetëdijshtëm që i njëjti ka gjendje të mirë materiale. Më tutje, trupi gjykues po ashtu ka vërtetuar si të vërtetuar faktin që i akuzuari ka vepruar në bashkëkryerje. Neni 22 i LPRSFJ-së thotë: “Nëse disa persona së bashku kryejnë vepër penale duke marrë pjesë në kryerjen ose në gfarëdo mënyre tjetër, secili nga ata do të dënohet sipas kësaj veprë penale”. Trupi gjykues ka vlerësuar se si i akuzuari nuk ka mundur vetëm të kryejë të gjitha veprimet inkriminuese për shkak të faktit që të pranishëm kanë qenë edhe persona tjerë të uniformuar. Megjithatë, mangësia e informatave mbi bashkëkryesit tjerë, nuk mund të çojë deri tek përfundimi që një person nuk do të ndiçet penalisht dhe nuk do të dënohet në përputhje me ligjin. Trupi gjykues përmend që nuk është e domosdoshme

që të gjithë bashkëkryesit të gjykohen. Ky përfundim është në përputhje me praktikën (jurisprudencën) vendore dhe ndërkombëtare. Trupi gjykues ka vërtetuar që i pandehuri Nenad Arsić është i përfshirë në kryerjen e kësaj veprë penale, ka vepruar sa bashku me të tjerët, ka pasur qëllim të caktuar, veprimtaria e tyre ka qenë e lidhur dhe drejtuar nga realizimi i qëllimit të tyre e që ka qenë dëbimi, torturimi dhe plaçkitja e banorëve civilë shqiptarë dhe veçanërisht kundër familjes Shala”.

45. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [APS. nr. 11/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke i dhënë përgjigje në pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ku ndër të tjera theksoi “[...] Gjykata e Apelit konstaton se pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit në lidhje me gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë nuk qëndrojnë, sepse sipas shkresave të lëndës gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim nuk ka mbetur në mëdyshje asnjë fakt edhe pse kjo pretendohet pa të drejtë në ankesën e parashtruar. Se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit të kundërshtuar, gjendjen e tillë faktike gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga provat e paraqitura në dëgjimin gjyqësor, e ato janë: dëgjimi i dëshmitarëve: Jakup Shala, Skënder Shala, Isak Shala, Enver Shala, Vahid Halili, Behlul Shala dhe Rexhep Berisha, Agron Haziri, Milivoje Susurović, Nada Susurović, Feim Simajli, Anelka Cup nga anë e mbrojtjes së të akuzuarit gjatë të gjitha fazave të procedurës dhe provat materiale: procesverbali mbi identifikimin, videoxhirimet dhe dëshmitë e tjera materiale të lexuara në dëgjimin gjyqësor, si procesverbalet mbi identifikimin e personit përmes fotografisë i datës 02.09.2019 (dy procesverbale mbi identifikimin), Sektori hetues i Krimeve të Luftës (Policia e Kosovës), xhirimet me video të datës 22.05.1999 (një CD) i shikuar në dëgjimin gjyqësor më 23.11.2002, kalendari i festave fetare serbe, kalendari kishtar për vitin 2020-2021, Vendimi mbi punësimin e të akuzuarit Nenad Arsić në Elektro-ekonominë e Kosovës i vitit 1994 e deri në periudhën e luftës, ku në bazë të të cilave ka konstatuar se i akuzuari Nenad Arsić si pjesëtar i forcave rezervë policore serbe më 21 maj 1999 ka marrë pjesë në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave të policisë serbe në një aksion policor në lagjen Emshir në Prishtinë, në familjen Shala me qëllim që të dëboj, torturoj dhe plaçkit popullin shqiptar si pjesë e planit operativ, kryerje e të cilit veprim është pranuar më herët si pjesëtar i Njësisë së rezervistëve të forcave të policisë serbe. I njëjti, në ditën kritike, ka qenë i veshur me uniformë të policisë serbe dhe i armatosur me armë automatike, dhe së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave policore serbe, të cilët deri më tani nuk janë identifikuar, rreth orës 8 kanë shkuar tek familja Shala ku së pari nga aty i kanë përzënë personat që ishin strehuar tek kjo familje, më pas pasi që nga më parë e dinin se familja Shala kishin kushte të mira ekonomike kërkuar para dhe armë dhe i rrahën dhe i torturuan ata, i torturuan dhe nënçmuan të dëmtuarit Jakup dhe Skënder Shala deri në ora 16:00hrs. Përveç kësaj ata shkatërruan dhe dëmtuan shtëpitë dhe objektet ndihmëse të familjes Shala dhe gjatë tërheqjes morën me vete një sasi goxha të madhe të parave, makinerisë bujqësore me naftë dhe vetura. Në bazë të këtyre provave të cilat janë paraqitur, vlerësuar dhe analizuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë por edhe nga provat e tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës është vërtetuar gjendja faktike në mënyrë të ligjshme sepse është vërtetuar se i akuzuari Nenad Arsić e ka kryer veprën penale të lartpërmendur”. Gjykata e Apelit arsyetoi edhe pretendimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me dëshmitë e dëshmitarëve, ku theksoi “[...] Nga përmbajtja e aktgjykimit rrjedh se nga ana e gjykatës së shkallës së parë është bërë vlerësimi i drejtë i dëshmitëve të dëshmitarëve, se ato janë vlerësuar në mënyrë të gjithmbarshme dhe në kontekst të dinamikës së rrethanave të rastit, dëshmitarët kanë ofruar sqarime për njohjen e të akuzuarit dhe nga deklaratat e tyre vërtetohet fakti se i akuzuari ka qenë në bashkë-kryerje me persona të tjerë, të cilët i kanë parë teksa po plaçkitnin pronën e të dëmtuarve, se i akuzuari i njëjte të dëmtuarit dhe e dinte se të

njëtit kishin gjendje të mirë ekonomike, dhe duke e ditur këtë rrethanë i njëjti kreu torturimin dhe rrahjen e të dëmtuarve derisa të tjerët kryen bastisjen dhe demolimin e shtëpisë, në kërkim të parave të cilat në fund i gjetën dhe i morën, gjë që ka qenë qëllim i përbashkët i të gjithë atyre. Se a ka qenë i akuzuari i mobilizuar dhe i uniformuar si pjesëtarë i forcave rezervë të policisë serbe gjatë periudhës kohore 1.10.1998 deri më 14.06.1999 siç është konstatuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ky fakt përpos me deklaratat e dëshmitarëve është vërtetuar edhe nga vetë i akuzuari se gjatë kësaj periudhe ka qenë i mobilizuar dhe i uniformuar si pjesëtarë rezervë i forcave policore pranë stacionit nr.1 në Prishtinë, ndërsa lagjja "Emshir" ishte nën përgjegjësinë e këtij stacioni policor".

46. Në fund, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës vendosi edhe Gjykata Supreme, e cila e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në tërësi. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 280/2021], ndër të tjera arsyetoi: "[...] Gjykata Supreme e Kosovës vëren se gjykatat e shkallëve më të ulëta, dhe në veçanti gjykata e shkallës së parë si gjykatë e fakteve, në mënyrë gjithëpërfshirëse kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha provat e administruara dhe në lidhje me mbrojtjen e të dënuarit. Siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj, e të cilin konstatim e ka pranuar plotësisht edhe kjo gjykatë, thelbi i akuzës bazohet në dëshmitë e të dëmtuarve Skënder dhe Jakup Shala, kështu që me të drejtë dëshmitë e tyre kanë qenë vendimtare në këtë çështje penale. Në këtë drejtim, pretendimi në kërkesë në lidhje me dëshmitë e dëshmitarëve – të dëmtuarve Jakup dhe Skënder Shala dhe fakti se ka pasaktësi në dëshmitë e tyre, gjegjësisht se ata kanë paraqitur prova të pavërteta në dëshmitë e tyre të dhëna gjatë fazave të procedurës penale, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, një pretendim i tillë është i pabazuar. Gjykata e shkallës së parë fillimisht dha një arsyetim për faktin se nga koha e kryerjes së veprës penale e deri në fillimin e procedurës penale kundër të dënuarit kishin kaluar disa vite dhe se dëshmitarët nuk e kishin denoncuar rastin në mënyrë që të sigurojnë faktet, përkatësisht të dhënat e tij personale pasi që ata nuk posedonin informacionet e plota për identitetin e tij. Megjithatë, nga ngritja e kallëzimit penal dhe në dëshmitë e tyre të mëvonshme, e deri në shqyrtimin gjyqësor dëshmitarët kanë qenë të bindur se pikërisht i dënuari ishte kryerësi i kësaj vepre dhe se ata nuk kishin asnjë mëdyshje në lidhje me këtë fakt. Për më tepër, dëshmitarët e kanë njohur mirë të dënuarin që nga koha para luftës edhe atë si ndihmës punonjës i Zhive Mitrović-it (fqinjë i dëshmitarëve), të cilit ai i ndihmoi në punët bujqësore. Nga kjo rrjedh fakti i vërtetuar se dëshmitarët janë mjaftueshëm të sigurt mbi faktin se kryerësi i këtij veprimi kriminal është pikërisht i dënuari në fjalë. Nuancat e mangësive dhe pasaktësive të vogla në dëshmitë e tyre, siç konstaton me të drejtë gjykata e shkallës së parë janë të papërfillshme, sidoqoftë qëndron fakti kryesor se dëshmitë e tyre kanë qenë konsistente në tërësinë e tyre. Pretendimet e avokatit mbrojtës të të dënuarit të bëra në kërkesë për pasaktësitë dhe paqartësitë në deklaratat e dëshmitarëve gjatë fazave të ndryshme të procedurës penale, sipas mendimit të Gjykatës Supreme janë të pabazuara dhe tentojnë të paraqesin pjesë të dëshmimeve të tyre, duke aluduar se dëshmitë e tyre janë jo të besueshme në tërësi. Përndryshe, dëshmitë e dëshmitarëve duhet të vlerësohen si tërësi dhe jo në pjesë të veçanta dhe të ndara, siç thonë mbrojtësit e të dënuarve. Dëshmitarët Jakup dhe Skënder Shala gjatë dëshmimeve të tyre e kanë përshkruar në tërësi ngjarjen e datës 21.05.1999, duke nisur nga fakti se disa pjesëtarë të policisë kanë shkuar tek shtëpitë e tyre dhe më pas duke e cekur faktin se në fillim "... pjesëtari i kombësisë rome ka filluar menjëherë t' i rrah, gjithashtu edhe me tëholluese derisa ajo nuk është thyer, dhe më pas erdhi Nenad-i i cili filloi t'i rrah, duke e goditur në krahë, shpinë dhe në fund edhe në duar..." (faqja 10 e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë). Andaj, nëse dëshmitë e dëshmitarëve vlerësohen në tërësi, atëherë rrjedh se të njëjtat janë të besueshme dhe konsistente, siç kanë konkluduar gjykatat e shkallëve më të

ulëta, e të cilat konkluzione i miraton në tërësi edhe kjo gjykatë. Për sa i përket procedurës së identifikimit, arsyetime të mjaftueshme janë dhënë në faqet 19-21 të aktgjykimit të shkallës së parë, për më tepër, procedura është zhvilluar sipas rregullit dhe me zbatimin e plotë të dispozitës ligjore të përcaktuar me KPPK. Dëshmitarët fillimisht e përshkruan të dënuarin dhe karakteristikat e tij, më pas atyre iu treguan fotografitë e 10 personave me përfaqësim tipare, linja dhe moshë të njëjtë, kështu që fakti për pasigurinë e dëshmitarit Skënder Shala në identifikim, në asnjë mënyrë nuk e bën jo bindëse pjesën tjetër të dëshmisë së tij, marrë parasysh se dëshmitarët e njihnin të dënuarin prej më herët dhe se kanë pasur kontakte me të disa herë (fakt të cilin nuk e konteston as vetë i dënuari gjatë mbrojtjes)”.

47. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përfshirë edhe pretendimin lidhur me dëshmitë e dëshmitarëve. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta u kishin dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.
48. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
49. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore, thekson se Gjykata Supreme “*ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, përkatësisht shkelje të nenit 120 të KPPK-së*”, megjithatë ai nuk e mbështet në asnjë mënyrë dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (shih, rastet e Gjykatës [KI64/20](#), parashtrues *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe [KI22/19](#), cituar më lart, paragrafi 43).
50. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Lidhur me pretendimin për pjesëmarrjen e gjyqtarit të njëjtë në dy shkallët e gjykimit

51. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës përgjatë pretendimeve të tij në kërkesë kishte theksuar se gjyqtari B. A., i cili kishte qenë gjyqtar në Gjykatën e Apelit kur ishte vendosur për ankesën e tij, i njëjti kishte marrë pjesë në vendimmarrje edhe lidhur me procedurën paraprake, që sipas tij nuk ka drejtë sipas ligjit.

52. Gjykata thekson që paragrafi 2, i nenit 39 të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, shkeljen e të cilit parashtruesi i kërkesës e pretendon, përcakton: “Gjyqtari përjashtohet si gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i kolegjit të apelit apo kolegjit të Gjykatës Supreme nëse ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal, përveç gjyqtarit që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë. Megjithatë, një gjyqtar nuk do të përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues”.
53. Gjykata vëren se në bazë të shkresave të lëndës rezultojnë se gjyqtari B. A., në cilësinë e anëtarit të Kolegjit, kishte nxjerrë Aktvendimin [PN1. S. nr. 74/2019] e 30 janarit 2019, përmes të cilit ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [PPPS. nr. 188/2019] të 23 tetorit 2019, të Gjykatës Themelore në lidhje me paraburgimin, dhe më pas kishte marrë pjesë në Kolegjin të Gjykatës së Apelit, duke vendosur në merita për rastin e parashtruesit të kërkesës përmes Aktgjykimit [ASP. nr. 11/2021] të 12 majit 2021, në vlerësimin e ankesës së parashtruesit të kërkesës të ushtruar kundër Aktgjykimit [PS. nr. 55/2019] të 24 dhjetorit 2020 të Gjykatës Themelore.
54. Nën dritën e kësaj, Gjykata thekson se mungesa e paanshmërisë gjyqësore nuk lind kur një gjyqtar ka marrë tashmë vendime formale dhe procedurale në faza të tjera të procedurës (shih, rastin e GJEDNJ-së, [George-Lavinii Ghiurău kundër Rumanisë](#), 15549/16 Aktgjykim i 16 qershorit 2020, paragrafi 67), siç edhe është situata në rastin e parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, problemet me paanshmërinë mund të shfaqen nëse, në fazat e tjera të procedurës, një gjyqtar ka shprehur tashmë një opinion mbi fajësinë e të akuzuarit (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Gómez de Liaño y Botella kundër Spanjës](#) 21369/04, Aktgjykim i 22 korrikut 2008, paragrafët 67-72).
55. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë që gjyqtari B. A. i Gjykatës së Apelit ka marrë vendime procedurale të pafavorshme për mbrojtjen lidhur me refuzimin e ankesës në lidhje me paraburgimin nuk është tregues i mungesës së paanshmërisë (shih rastin e GJEDNJ-së, [Khodorkovskiy dhe Lebedev kundër Rusisë](#) 11082/06 dhe 13772/05, Aktgjykim 25 korrikut 2013).
56. Për më tepër, fakti i thjeshtë që një gjyqtar apo trup gjykues ka marrë tashmë vendime paraprake nuk mund të konsiderohet në vetvete si shqetësim i arsyeshëm për paanshmërinë e tij. Ajo që ka rëndësi është shtrirja dhe natyra e masave të marra nga gjyqtari para gjykimit. Po kështu, fakti që gjyqtari ka njohuri të hollësishme për dosjen e rastit nuk sjellë ndonjë paragjykim nga ana e tij që do të parandalonte që ai të konsiderohej i paanshëm kur merret vendimi për meritat. As një analizë paraprake e informacionit në dispozicion nuk do të thotë se analiza përfundimtare e rastit është paragjykuar (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Morel kundër Francës](#) 34130/96, Aktgjykim i 6 qershorit 2000, paragrafi 45 dhe referencat aty).
57. Për të kapërcyer supozimin e paanësisë, Gjykata duhet të ketë një dëshmi më të fortë të paragjyqimeve sesa një aktvendim që në esencë ishte procedural. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për pjesëmarrjen e gjyqtarit B. A., në dy faza vendimmarrëse gjatë procedurave gjyqësore, nuk janë bindëse për Gjykatën se kishte njëanshmëri nga ana e tij. (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Miminoshvili kundër Rusisë](#) 20197/03, Aktgjykim i 28 qershorit 2011, paragrafi 114).
58. Në dritën e sa më sipër, Gjykata thekson se pretendimet që mund të ketë pasur parashtruesi i kërkesës për paanësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit janë të pabazuara sepse sikurse që përcaktohet me paragrafin 2 i nenit 39 të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale: (i) vendimi i gjyqtarit B.A. lidhur me paraburgimin është

vendim procedural që nuk ka përcaktuar fajësinë apo pafajësinë apo të drejtat dhe obligimet e parashtruesit të kërkesës; (ii) nuk ka asgjë në shkresat e lëndës që sugjeron se gjyqtari B.A., ka shprehur qëndrim armiqësor apo vullnet të keq ndaj parashtruesit të kërkesës; dhe se (iii) gjyqtari B.A., nuk ka shprehur paraprakisht opinion lidhur me fajësinë e parashtruesit të kërkesës çka do ta komprometonte procesin penal kundër tij.

59. Rrjedhimisht, ky pretendim refuzohet si qartazi i pabazuar.
60. Andaj, mbi bazën e arsytimit të mësipërme, Gjykata konkludon se kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa e parashtruesit për moszbulim të identitetit

61. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij kishte kërkuar gjithashtu që identiteti i tij të mos zbulohet.
62. Parashtruesi i kërkesës lidhur me kërkesën për moszbulim të identitetit, në formularin e kërkesës te rubrika se a dëshironi të zbulohet apo jo identiteti, ai e ka zgjedhur rubrikën të mos zbulohet.
63. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 32 (6) të Rregullores së punës, i cili parasheh: “(6) Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë nga rregulli i qasjes publike në informata në procedurën në Gjykatë. Gjykata me shumicë votash autorizon moszbulimin e identitetit ose e jep atë pa një kërkesë nga një palë. Kur lejohet moszbulimi i identitetit nga Gjykata, pala duhet të identifikohet vetëm me initiale ose me shkurtesa apo me një shkronjë të vetme”.
64. Duke u bazuar në atë se parashtruesi nuk e ka arsyetuar por vetëm e ka cekur, Gjykata konsideron se kjo nuk është bazë për miratimin e kësaj kërkesë (shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KI74/17](#), parashtrues *Lorenc Kolgjera*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2017, [KI72/19](#), parashtrues *Amir Hamza*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 10 tetorit 2019, paragrafi 34).
65. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit për moszbulim të identitetit duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 32 (6), 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 22 dhjetor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani